



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:242053

Datë: 20.09.2024

Numri i dokumentit: 06186306

C.nr.26/2019

PROCESVERBAL I SEANCËS PËRGATITORE

I përpiluar më datë 20.09.2024, në GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil në çështjen juridike të paditëses Banka TEB. Sha - Prishtinë të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.S kundër të paditurve S.A. të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. K.S dhe B.A. , me objekt kontesti realizim i borxhit.

P r e z e n t:

Gjyqtari:
Leotrim Gashi

Për paditësen
A.S. sipas autorizimit

Zyrtare ligjore
Liridona Bajrami

Av. K.S. për të paditurin S.A.
Për të paditurën B.A. askush

Për të paditurit:

Pyeten palët se a kanë vërejtje në përbërjen e gjykatës:

Pa vërejtje nga palët.

Seanca është publike

Filloj ne ora 09:30.

Gjyqtari i çështjes e hap shqyrtimin mbi këtë çështje, e publikon lëndën e shqyrtimit dhe konstaton se në këtë seancë prezent është përfaqësuesja e autorizuar i paditëses A.S. dhe përfaqësuesi i të paditurit S.A. Av. K.S. ndërsa mungon e paditura B.A. për të cilën nga

fletëkthesa e gjykatës e pranuar më datë 11.09.2024, konstatohet se dorëzimi është provuar, pala gjendet në botën jashtme.

Para se të vazhdohet tutje përfaqësuesi i të paditurit deklaron se janë të interesuar të arrijnë pajtim gjyqësor sepse i padituri nga viti 2022, është duke e paguar me rregull borxhin.

Përfaqësuesja e paditëses deklaron se:

Pasi që i padituri S.A. është duke e paguar borxhin dhe kemi një marrëveshje jashtëgjyqësore, tërhiqemi nga padia për të paditurën B.A. .

Gjykata në kuptim të nenit 261 të LPK –së, pasi që të paditurës B.A. nuk është arritur akoma ti sigurohet adresa në mënyrë që të kontaktohet për këtë procedurë gjykata merr:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET E TËRHEQUR padia C.nr. 26/2019, e datës 23.01.2019, për të paditurën B.A. .
- II. Ndaj këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.

Pasi që paditësja është tërhequr nga padia për të paditurën B.A. dhe në seancë prezanton përfaqësuesi i të paditurit të vetëm S.A. , gjykata konstaton se ka kushte ligjore për mbajtjen e seancës, e si rrjedhojë merr:

A K T V E N D I M

Seanca e sotme mbahet dhe e njëjta është publike.

Gjykata i njofton palët prezente se duhet të mbajnë rendin dhe qetësinë në gjykatë dhe nuk duhet të flasin derisa gjykata të iu jap fjalën, për prishje të rendit dhe qetësisë në seancë gjyqësore, gjykata mund që duke u bazuar në nenin 289.2 të LPK-së, fillimisht do t'i qortoqë palët dhe nëse kjo rezulton të jetë e pasuksesshme mundet që ti largoj nga salla dhe t'iu shqiptojë gjobë deri në 500 euro.

Gjykata i njofton palët së në këtë seancë përgatitore duhet të parashtrojnë të gjitha faktet në të cilat mbështesin kërkesat e tyre si dhe të propozojnë të gjitha provat më të cilat pretendojnë të vërtetojnë faktet e tilla.

Gjykata i njofton palët se kontestin mund ta zgjidhin edhe në procedurën e ndërmjetësimit, në pajtim me nenin 411 të LPK – së si dhe me anë të pajtimit gjyqësor siç parashihet në nenin 412 të LPK – së.

Lidhur me mundësinë e zgjidhjes së këtij kontesti përmes procedurës së ndërmjetësimit apo pajtimit gjyqësor, përfaqësuesja e paditëses, deklaron:

Qëndrojmë prapa padisë dhe pajtohemi që me të paditurin S.A. , të arrijmë pajtim gjyqësor, ashtu që e precizojmë obligimin që i ka mbetur aktualisht të paditurit, e që është në shumë prej 1,485.15 euro, të cilat duhet t’i paguajë në 8 këste mujore ashtu që 7 këstet e para duhet të jenë në shumën prej 180 euro ndërsa kësti i 8 – fundit, duhet të jetë 225.15 euro, ashtu që pagesat e kësteve duhet të paguhen nga data 20-30 të çdo muaji - kësti, duke filluar nga 20-30 shtator 2024.

Lidhur me mundësinë e zgjidhjes së këtij kontesti përmes procedurës së ndërmjetësimit apo pajtimit gjyqësor përfaqësuesi i të paditurit S.A., deklaron:

Pajtohemi që të arrihet pajtimi gjyqësor sipas kushteve të theksuara nga paditësja.

Palët deklarojnë se kanë arritur këtë:

PAJTIM GJYQËSOR

- I. DETYROHET i padituri S.A. , që në emër të borxhit – kredisë, t’ia paguajë paditëses Banka TEB sh.a, shumën prej 1,485.15 euro në 8 këste mujore, ashtu që 7 këstet e para duhet të jenë në shumën prej 180 euro ndërsa kësti i 8 – fundit, duhet të jetë 225.15 euro, ashtu që pagesat e kësteve duhet të paguhen nga data 20-30 të çdo muaji - kësti, duke filluar nga 20-30 shtator 2024, e deri në përmbushjen totale të detyrimit, e cila shumë duhet të paguhet në xhirollogarinë e paditëses..., në Bankën TEB, Sh.a.

- II. OBLIGOHET i padituri, që t'i paguajë paditëses shpenzimet e procedurës në shumë prej 60 euro, të cilën duhet të paguajë në afat prej 30 ditësh pas pranimit të aktvendimit me të cilin aprovet pajtimi gjyqësor, në llogarinë e përfaqësuesve të paditëses – Debt Loan Recovery sh.p.k, me numër..., në bankën Pro Credit Bank.

Gjykata në bazë të nenit 411 dhe 412 të LPK –së, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pajtimi gjyqësor, i lartpropozuar nga ana e palëve ndërgjyqëse.
- II. Ky paktim paraqet titull ekzekutiv dhe mund të goditet vetëm me padi.

Procesverbali pasi u dëgjua me zë i njëjti edhe u nënshkrua pa vërejtje.

Përfundoi në ora 10:39 minuta.

Përfaqësuesja e paditëses

Përfaqësuesi i të paditurit

V ë r t e t o j n ë

Zyrtarja ligjore

Gjyqtari
